



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 8

Tiranë – E martë, 24 janar 2017

PËRMBAJTJA

| | Faqe | |
|---|---|-----|
| Vendim i Kuvendit nr. 1/2017, datë 16.1.2017 | Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes, negocimit të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ A.S.”, si dhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016.... | 217 |
| Vendim i Kuvendit nr. 2/2017, datë 16.1.2017 | Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar nga realizimi i marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ A.S.””, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 31/2016..... | 217 |
| Vendim i Kryetarit të Kuvendit nr. 3, datë 24.1.2017 | Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi..... | 218 |
| Dekret i Presidentit nr. 9947, datë 17.1.2017 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 219 |
| Dekret i Presidentit nr. 9948, datë 17.1.2017 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... | 219 |
| Dekret i Presidentit nr. 9949, datë 17.1.2017 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... | 220 |



**VENDIM
Nr. 1/2017**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT “PËR
HETIMIN DHE VERIFIKIMIN E
ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË
FUQI, MBROJTJEN E INTERESIT TË
SHTETIT SHQIPTAR GJATË
PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES, NEGOCIMIT TË
MARRËVESHJES SË SHITJES SË
AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR.
10 116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN
E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR
QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT
TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
(OSSH) SHA NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE CEZ AS”, SI DHE
EVIDENTIMIN E EFEKTEVE
NEGATIVE FINANCIARE TË
SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E
ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”,
NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 30/2016**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negociimit të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë

dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ A.S.-së”, si dhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016, zgjatet për një periudhë njëmuajore, duke filluar nga data 21 janar 2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 16.1.2017

**KRYETARI
Ilir Meta**

**VENDIM
Nr. 2/2017**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT “PËR TË
KONTROLLUAR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE
MBROJTJES SË INTERESIT TË SHTETIT
SHQIPTAR NGA REALIZIMI I
MARRËVESHJES PËR ZGJIDHJEN ME
MIRËKUPTIM NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “CEZ
AS”“, NGRITUR ME VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 31/2016**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 8, 9 dhe 13, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar nga realizimi i marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ A.S.”“, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 31/2016, zgjatet deri në datën 21 shkurt 2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 16.1.2017

**KRYETARI
Ilir Meta**



VENDIM
Nr. 3, datë 24.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
 DHE RREGULLAVE TË HEDHJES SË
 SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E
 ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
 EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d dhe pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 221 dhe 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe të nenit 106 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit,

VENDOSI:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR
ORGANIZIMIN E PROCEDURËS SË
HEDHJES SË SHORTIT

1. Miratimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

2. Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi.

3. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimin e çdo faze të saj krijohet një Sekretariat Teknik. Numri i anëtarëve dhe përbërja e Sekretariatit Teknik caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.

4. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë cakton datën dhe orën e organizimit të shortit.

Data dhe ora e organizimit të shortit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

5. Kryetari i Kuvendit njofton zyrtarisht për datën dhe orën e organizimit të shortit Prokurorin e Përgjithshëm, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, të cilët ftohen të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për të qenë prezent në organizimin e shortit.

Përfaqësuesit e këtyre institucioneve të caktuar për të marrë pjesë në organizimin e shortit nuk duhet të jenë të njëjtë me personat e përfshirë në listën e kandidatëve të paraqitur për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

6. Për zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit njoftohet dhe ftohet të marrë pjesë si vëzhgues Avokati i Popullit, përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, organizata partnere ndërkombëtare dhe media.

7. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Sekretariati Teknik sigurohet paraprakisht për praninë e:

a) përfaqësuesve të dërguar nga institucionet e përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

b) Avokatit të Popullit ose të përfaqësuesit të autorizuar prej tij;

c) Përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të organizatave partnere ndërkombëtare, në cilësinë e vëzhguesve; dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit mund të marrin pjesë edhe kandidatët e propozuar nga institucionet e përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

8. Mosparaqitja e përfaqësuesve të institucioneve të përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nuk pezullon procedurat e hedhjes së shortit. Në këtë rast tërheqja e shortit për institucionin përfaqësuesi i të cilit nuk është prezent bëhet nga përfaqësuesi i një institucioni tjetër dhe në rast se edhe këto mungojnë Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit cakton një punonjës të shërbimeve të Kuvendit për të tërhequr shortin për institucionin, përfaqësuesi i të cilit nuk është prezent.

KREU II
PROÇESI I HEDHJES SË SHORTIT

9. Shorti organizohet në dy kuti transparente. Në njërin prej kutive vendosen goglat dhe në kutinë tjetër më pas vendosen goglat në të cilat janë futur shiritat e letrës ku janë shënuar emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion sipas listës së përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.

10. Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve futen në gogla. Numri i goglave duhet të përputhet me numrin e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.



11. Radha e futjes së goglave në kuti dhe rradha e hedhjes së shortit përcaktohet duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- a) kandidatë të Gjykatës Kushtetuese;
- b) kandidatë të Gjykatës së Lartë;
- c) kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme;
- ç) kandidatë nga gjykatat e apelit;
- d) kandidatë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;
- dh) kandidatë nga gjykatat administrative.

12. Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” tërheqin nga kutia përkatëse me rradhë goglat.

Përfaqësuesi pasi e hap goglën, e lexon me zë të lartë emrin e kandidatit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi që është i shënuar në të dhe ia tregon Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrin.

Shiriti i letrës që gjendet brenda saj, i dorëzohet Sekretariatit Teknik.

13. Kandidati, emri i të cilit është shënuar në shiritin e letrës, do të jetë anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

14. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, të parashikuar nga pikat 9 deri në 13 të këtij vendimi, zgjidhen edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

15. Pas tërheqjes së goglave nga përfaqësuesi i parë, kutia transparente zbrazet dhe në të futen goglat me emrat e kandidatëve të dërguar nga institucioni tjetër sipas rradhës së caktuar në pikën 11 të këtij vendimi.

16. Rezultati i Shortit shpallet nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë.

17. Procedura e hedhjes së shortit regjistrohet në audio dhe video.

18. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së organizimit dhe hedhjes së shortit sipas parashikimeve të këtij vendimi mbahet procesverbal.

19. Rezultatet e shortit së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

20. Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit.

21. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Sekretariati Teknik për ndjekjen e procedurave të nevojshme të zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 9947, datë 17.1.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Arber Bexhet Shkodra
2. Narcis Mehmet Alibegu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9948, datë 17.1.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:



1. Zhaklin Dashamir Çerma
2. Laurent Fadil Ibra
3. Merjem Laurent Ibra
4. Fatime Laurent Ibra
5. Hatixhe Laurent Ibra
6. Antonio Nikoll Ndoja
7. Etleva Rushit Riering (Bebo)
8. Blerina Agim Manaj
9. Romina Roland Mali (Mita)
10. Pranvera Hysen Krasniqi
11. Kitti Iglj Osmani
12. Mirlind Valdet Groshi
13. Marsela Gani Potka
14. Jurgen Durim Lamaj
15. Demona Bajram Zela (Hidri)
16. Deborah Amarildo Zela
17. Nertila Halil Furriku
18. Valmira Adem Hala
19. Sabina Sadik Hoxhallari (Ibrahimi)
20. Kevin Hysni Hoxhallari
21. Liljana Toma Stajkiq (Bercamaj)
22. Miško (Mishko) Rado Stajkiq
23. Srđan (Sergjan) Rado Stajkiq
24. Etleva Zini Gjoni (Haskaj)
25. Ledia Roland Veshi
26. Boris Nadi Trashani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9949, datë 17.1.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gentjana Xhafer Nerguti (Elezaj)
2. Anna Dritan Nerguti
3. Alma Enver Karagjozi (Bajraktari)
4. Fatjona Azem Ismailaj (Gjongecaj)
5. Lirsën Sali Myrtaj
6. Gjergj Mark Tatiç
7. Guxim Jaçe Canka
8. Enkeleda Brahim Ndoka (Reçi)
9. Sonja Fation Zeka
10. Erison Fation Zeka
11. Drita Mahmut Shehu (Koldashi)
12. Taulant Sejdiu Ymeralilaj
13. Ilir Sokol Blakçori
14. Anxhelo-Panajot Ardian Prici
15. Vjollca Tafil Xhydollari (Hysenllari)
16. Raimonda Izet Kordalli (Zdrava)
17. Alfred Halil Leti
18. Edmond Nikoll Tusha
19. Johannes Edmond Tusha
20. Tokjona Edmond Tusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë